Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ekspert Shqyrtues, Agim SHEQIRI Nënshkrimi_____	Data e autorizimit të ekspertit 05.04.2022	Data e dorëzimit të raportit 19.04.2022	Nr. i lëndës: 86/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.04.2022 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka pranuar ankesën me nr. prot. 86 /21 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Bletaria Egzoni", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve " për aktivitetin e prokurimit nr. ref 656-22-1926-1-2-1të realizuar nga Komuna e Ferizajt.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë për të hapur , vlera e parashikuar e kontratës: 40,000.00 €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

OZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMOR SIPAS OE ANKUES

Neni 1 i LPP-së
- Neni 7 i LPP-së
- Neni 27 i LPP-së
- Neni 28 i LPP-së
- Neni 69 i LPP-së
- Neni 18.9 i RRUOPP
- Neni 26.4 i RRUOPP

Ne si OE: N.T.P "Bletaria Egzoni " të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, duke u bazuar në Specifikimet teknike të detyrueshme të kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit shihet qartë që janë vendosur specifika teknike diskriminuese për kompanitë që kanë menduar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit dhe favorizim për kompaninë e caktuar pasi që janë vendosur specifikat teknike të një kompanie APIMAYE nga Turqia e cila prodhon këto koshere të bletëve dhe pjesët përcjellëse të cilat janë nga plastika dhe vetëm kjo Firmë prodhon këto modele.

Specifikat e vendosura në dosje të tenderit nga ana e AK-së i janë përshtatur një kompanie vendore e cila ka vetëm një distributor në Kosovë, fakt ky që tregon shumë qartë favorizimin që po i bëhet OE të caktuar dhe diskriminimin që po i bëhet OE që mendojnë të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit

Ne si OE i interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit kemi kërkuar oferta nga prodhuesi i këtyre artikujve (specifikat e vendosura i janë përshtatur prodhuesit të caktuar), të cilët na kanë njoftuar se kanë distributor në Kosovë. i cili është Bina SH.P.K , i cili ka furnizuar AK në dy vitet e fundit me të njëjta produkte.

Mjafton një kërkim i thjeshtë në Google dhe mund të vërtetohet se Specifikimet teknike të kërkuara i përshtaten 100% atyre të kompanisë se lartshënuar madje edhe Foto e produktit është e njëjtë dhe renditja është e njëjtë me artikujt në katalogun gjeneral të kompanisë Apimaye.

Ne gjithashtu për të njëjtin aktivitet të prokurimit në vitin 2021 kemi bër Ankesë për te njëjtin aktivitet të prokurimit në OSHP me Nr. Prokurimi: 656-21-2137-1-2-1. Nr,Brendshëm:656-21-49-121, Me Titull: Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve. i cili është i pezulluar dhe është ende ne proces dhe nuk është marr akoma vendimi nga Bordi i OSHP-së por është vendimi i ekspertit shqyrtues me numër të lëndës 389/21, Mendimi i ekspertit shqyrtues thotë kështu: Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet janë të bazuara dhe i rekomandon Autoriteti Kontraktues që ne dosjen te tenderit të eliminoj kritere kufizuese dhe gjithashtu gjate hartimit të specifikimeve teknike të mos i referoheni një prodhuesi të caktuar. Ne do të ja bashkangjesim së bashku kësaj kërkese edhe raportin e ekspertit shqyrtues.

Andaj duke u bazuar në këtë fakt po shihet qartë se AK-ja e ka favorizuar një kompani duke e kufizuar konkurrencën në maksimum, fakt ky që shihet qartë nga specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe nga kompania *APIMA YE nga Turqia* të cilat po ju prezantojmë më poshtë.

Specifikimet e kërkuara

Kosherja e bletëve duhet të ketë këto karakteristika:

1. Duhet të jetë e kombinuar nga druri dhe plastika
2. Kapaku - mbulesa e sipërme duhet tëjetë plastikë e cila ofron izolim terrnik, i qëndrueshëm dhe e cila nuk krijon zhurmë
3. Kapak i brendshëm i mbulesës së sipërme - ushqyesja duhet të jetë në sasi prej 4 litrave
4. Muret anësore të kosherëve duhet të jenë kuti druri në katër anët me dimensione të brendshme të standardizuara
5. Një cope: skarë për bletën amë e cila duhet të jetë e ndërtuar ndaras për të parandaluar ngjitjen në korniza në mënyrë që bletët të lëvizin lirshëm.
6. Hyrja e rrumbullakët për bletë e cila shërben për kontrollin e qasjes në hyrje të koshereve e

cila duhet të ketë katër opsione: plotësisht i hapur: përjashtimi i mbretëreshës, i mbyllur me vetilim dhe plotësisht i mbyllur

7. Duhet të jetë e materialit që pastrohet lehtë.
8. Reduktues i hyrjeve - daljeve të bletëve e cila mund të mbyllet plotësisht gjatë udhëtimeve
9. Pjesa për mjalt: (Ergo)
10. Pjesa për inkubacion (Ergo)
11. Kapaciteti 20 komiza Langstrotli 25 (47Smm X 250 mm),
12. Katër copa kapse dhe dorëz për mbajtje (INOX): me vegë plastike
13. Një copë tepsi për polen me bazë ergonomike
14. Një copë. ndalues poleni me bazë ergonomtke,
15. Baza ergonomike (plastik) me standardet Langstroth e përshtatshme për të gjitha llojet e koshereve - me sirtarë dhe skarë që e pamundëson futjen e parazitëve varroa, me sirtar me grackë - kurthë polem)

Argumentet e prezantuara nga ana jonë janë lehtë të konfirmueshme dhe qëndrojnë plotësisht ku këtë lakt mund ta vërtetoni shumë lehtë në këtë link: https://shop.apimaye.com.tr/ari- kovanlari/ergonomik-kovan/ergonomik-ahsap-kovan.

Pra specifikimet teknike të përcaktuara nga AK janë 100% të njëjta me renditje dhe me foto sipas emërtim të katalogut të kompanisë Apimaye, e cila si distributor të autorizuar për Kosovë ka kompaninë Bina SH.P.K.

Prandaj këto specifikime teknike duhet të ndryshohen, me qëllim që të zgjerohet mundësia e ofertimit e sa më shumë operatorëve ekonomik dhe me qëllim të hapjes së konkurrencës, pasi që lidhur me lëndën e Aktivitetit të Prokurimit në tjalë : *Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve*, në dy vitet e fundit ka qenë vetëm një Operator Ekonomik i cili ka furnizuar Autoritetin Kontraktues: Komuna Ferizaj. andaj ndryshimi i specifikimeve teknike nga ana e AK-së e hap konkurrencën dhe mundësinë e ofertimit të shumë kompanive. sepse me këto specifikime teknike siç janë të përcaktuara tani nga AK i mundësohet vetëm një OE pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj për të pasur një aktivitet të prokurimit më transparent dhe efikas duke e arritur edhe qëllimin e LPP-së duhet të ndryshohen këto specifikime teknike, pasi që me këto specifikime teknike siç i ka përcaktuar AK-ja po ju krijohet mundësia e favorizimeve të kompanive të caktuara me rastin e ofertimit dhe mundësia shumë e madhe e manipulimeve në vlerësim dhe shpallje të fituesit, e po ashtu krijohet mundësia shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit sepse kompanitë të cilat e kanë një avantazh qysh në start të ofertimit ofertojnë me çmime më të larta.

Po ashtu edhe tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe professional, tek pika 2 ku është kërkuar: *2. Kosheret duhet të kenë A-testet e kryera nga ndonjë*

institut shtetëror i akredituar për standardet globale të cilësisë (ICAR).

Kërkesa e lartcekur është diskriminuese, eliminon konkurrencën dhe favorizon Operatorët e caktuar ekonomik, për faktin se lidhur me lëndën e Aktivitetit të Prokurimit në fjalë : Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve, në dy vitet e fundit ka qenë vetëm një Operator Ekonomik i cili ka furnizuar Autoritetin Kontraktues: Komuna Ferizaj. Kjo nënkupton se vetëm ky Operator posedon dëshmi - evidencën e kërkuar sikurse në fotot e paraqitura me lartë, dhe njedhimisht, është e pamundur për Operatorët e tjerë Ekonomik të paraqesin dëshmi.

Andaj kërkesa e lartcekur shihet qartë se e favorizon haptas operatorin ekonomik të caktuar dhe njëkohësisht e kufizon konkurrencën, për kompanitë të cilat kanë menduar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE. ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Ne me dt. 29.03.2022 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrlim. mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore.

Sa i përket arsyetimit të AK-së ku e ka cekur se pretendimi ynë ankimor në lidhje me specifikimet teknike është i pa bazuar sepse mjafton të futeni në GOOGLE dhe të kërkoni kompani qe kane keto produkte. ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është tërësisht i pa bazuar dhc nuk qëndron për faktin se pretendim i yni ankimor ka qenë që janë vendosur specifikat teknike të një kompanie APIMAYE nga Turqia e cila prodhon këto koshere të bletëve dhe pjesët përcjellëse të cilat janë nga plastika dhe vetëm kjo Firmë prodhon këto modele. Pra ne e kemi cekur shumë qartë se specifikimet teknike janë të përshtatura kompanisë të caktuar. pasi që specifikimet teknike të specifikuara nga AK dhe Sqarimet shtes qe ka paraqitur AK ne DT jane specifikimet të cilat i kemi përmendur më lartë të kompanisë Apimaye e cila distributor për Kosovë ka Bina SH.P.K. janë 100% të njëjta, ky nuk mund të quhet ndryshe përveq se favorizim i hapur nga OE të caktuar. Ndërsa sa i përket arsyetimit tjetër të AK-së në lidhje me pretendimin tonë ankimor ku thot si me poshte

Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë shihet qartë tendenca e AK-së për dhënien e kontratës OE të caktuar, pasi që gjitha kërkesat dhe specifikimet teknike të lartpërmendura i përshtaten vetëm një kompanie të caktuar.

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, pasi që nga faktet e lartcekura

shihet qartë se kush mund ti plotësojë këto kërkesa dhe specifikime teknike, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe. Ne me dt. 05.05.2021 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, pasi që nga faktet e lartcekura shihet qartë se kush mund ti plotësojë këto kërkesa dhe specifikime teknike. prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa dhe specifikime teknike diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë*.

Kërkesat dhe specifikimet teknike të lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të LPP- së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj të gjitha kërkesat dhe specifikimet teknike të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara

Kërkesat dhe specifikimet teknike që u kundërshtuan më lartë. janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit pothuajse shumë kompanive dhe janë në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik. sepse aty shkruan qartë se *"Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aj'tësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 28.2 të LPP-së ku është e cekur shumë qartë se *"Autoriteti kontraktues do t 'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik*

Pra autoriteti kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë. përveç se nuk e ka marr parasysh këtë dispozitë, edhe i ka diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë. kërkojmë nga ju si OSHP që

të detyroni autoritetin kontraktues që ky aktivitet i prokurimit të ndryshohet apo të anulohet të kthehet në piken zero. që të mundësohet edhe OE të tjerë të marrin pjesë në këtë aktivitet pa u diskriminuar në aktivitetin në fjalë. dhe po ashtu specifikimet teknike dhe kërkesat c dosjes se tenderit duhet të thjeshtëzohen në mënyrë që të lejohet

KRITERET PËR VLERËSIM

Çmimi me i ulet

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Pasi aktiviteti i prokurimit është në fazën tenderuese AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin si në vijim:

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana juaj, ne si Autoritet Kontraktues konsiderojmë se pikat ankimore të paraqitura në kërkesë për ri-shqyrtim janë të pabazuara. Lidhur me pretendimet tuaja se AK ka bere diskriminim kur ka vendosur specifikacionet teknike te detyrueshme ne DT, nuk qëndron kjo per arsye se përveç kompanisë Apimaye e cila sipas OE është I vetmi prodhues ose distributor qe ka ketë lloj koshere, NUK QENDRON, kjo për faktin se po u fute ne Google ju mund te gjeni shume kompani qe kane këto produkte dhe këto specifika. Për ma shume shikoni linqet e mëposhtme:

https://www.amazon.com/Thermo-Beehive-Plastic-Insulated-Included/dp/B08SC42RVX?th=1

https://inhabitat.com/this-recycled-plastic-beehive-is-designed-for-happy-bees/

https://apimaye-usa.com/

https://www.alibaba.com/product-detail/Turkish-Bee-Hives-Beekeeping-Equipment-Wooden 1600068095266.html

https://www.googleadservices.com/pagead/aclk?sa=L&ai=DChcSEwisztiy-ur2AhUB53cKHTARDtoYABACGgJlZg&ae=2&ohost=www.google.com&cid=CAESauD2bYO1ryIhrGJluIiyz7RXW vlEKr3wLaoIQEWVWiD1pwKG7WJ47 W1DSRSzP-MXzg9zAwmdlsfNcxlKkkm HeavojogwUt0u67xHNGFhiDlucScKHPvHBjStDzfkZAtR9FJmWJS5qQI&sig=AOD642LnAeZIJfGLUBW8B3jtLUoWntFUg&q&adurl&ved=2ahUKEwjmts2y-ur2AhXfSfEDHSzeAwwQ0Qx6BAgEEAE

AK nuk ka njohuri se kompani te caktuara nga Turqia kane marrëveshje me kompaninë BINA SHPK, siç ju keni pretenduar. Marrëdhëniet e bashkëpunimit ne mes kompanive, ne si AK nuk I përcjellim. Kjo është përgjegjësi e juaja dhe e secilës kompani qe te keni marredhenje kontraktuale me prodhues apo diler te ndryshëm ne rajon, Evrope dhe bote. Ne si AK nuk kemi vendosur asnjë foto te

produkteve ne DT qe ju pretendoni.

Specifikat e prezantuara ne DT mund te gjinden tek secili prodhues apo diler ne linqet e larte shënuara.

AK nuk mund te ndryshoj specifikat dhe tua përshtatë juve apo ndonjë kompanie tjetër. Është interes I fermerëve por edhe komunës qe te kemi produkte sa me kualitative gjithmonë duke mbrojtur shëndetin e bletëve.

Gjithashtu tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, A-testi është dëshmi qe produkti I ofruar është I standardeve dhe cilësisë se kërkuar. A-testet janë dëshmi qe garanton AK se produkti nuk është I dëmshëm për shëndetin e bletëve . Kjo kërkese është e domosdoshme dhe se ne si AK nuk mund tua përshtatim juve apo kujtdo tjetër kërkesat dhe ta heqim ketë kriter

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sa për informim Eksperti Shqyrtues me datën 25.05.2021 lidhur me ketë aktivitet të prokurimit ka lëshuar ekspertizën me nr. 389/21 ku edhe ka dhënë mendimin e tij lidhur me pretendimet ankimore të parashtruar nga OE “Bletaria Ekzoni”

Ankesa e parashtrua r me nr. 86/22 ka të bej me të njëjtin aktivitet te prokurimit ku eksperti ka dhënë mendim dhe tani nuk e sheh të nevojshme te jap dy ekspertiza për çështje te njëjtë pasi qe lidhur me ankesën paraprake OSHP nuk ka lëshuar ndonjë vendim i cili sipas dispozitave të LPP-së duhet zbatuar nga ana e AK-së.

Të gjitha vlerësimet lidhur me ketë aktivitet te prokurimit eksperti i ka dhënë ne ekspertizën e datës 25.05.2021 dhe mbetet pranë asaj ekspertize dhe nuk e sheh te nevojshme që për aktitivtet te njëjtë të prokurimit, pretendime ankimor te njëjta dhe të parashtruara po nga i njëjti OE të jap

konstatime dhe vlerësim tjera përveç atyre që janë dhënë në ekspertizën me nr. 389/21

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues nuk mund të jap rekomandim deri sa ende lidhur me ketë aktivitet të prokurimit nuk kemi vendim të Panelit Shqyrtues ashtu siç parashihet me LPP.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues,- Komuna e Ferizajt
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues: "Bletaria Egzoni"